



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 469/14 prot.

Datë 09.03.2026

V E N D I M
Nr.365/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.03.2026, shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72023-12-12-2025, me objekt: “LOTI 2 Filtra deleukocitar dhe bashkues laborator për masat trombocitare”, me fond limit 18,960,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Fedos” SHPK me NIPT K01514009I dhe adresë: Rruga Kujtim Laro -Tirane, Nr pasurie 3/22,Kati 2, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK me NIPT L62217032L dhe adresë: Rruga Allaman Dervishi, Pallati Classic A.M. Nr.31, Kthesa e Kamzës, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar

I.4. Operatori ekonomik ankimues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.12.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72023-12-12-2025, me objekt: “LOTI 2 Filtra deleukocitar dhe bashkues laborator për masat trombocitare”, me fond limit 18,960,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 15.01.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 03.02.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|-------------------|-----------------------------|
| 1. FEDOS | 18,900,000 lekë kualifikuar |
| 2. Albadent Group | 16,666,007 lekë kualifikuar |

II.4. Në datën 06.02.2026, në Sistemin e Prokurimit Elektronik autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak të procedurës së prokurimit.

II.5. Në datën 13.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6325, si dhe nr. Protokoli 469/2026 datë 13.02.2026, i operatorit ekonomik “Fedos” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72023-12-12-2025, me objekt: “LOTI 2 Filtra deleukocitar dhe bashkues laborator për masat trombocitare”, me fond limit 18,960,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 469/1 prot., datë 13.02.2026 dhe formulari i publikimit Nr. 469/8 prot., datë 26.02.2026 (korigjuar me vendimin nr. 316/2026, datë 25.02.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik).

II.7. Në datë 20.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar “Formulari i paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, dorëzuar nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK, protokolluar pranë KPP-së me nr. 469/2 prot., datë 23.02.2026.

II.8. Nëpërmjet shërbimit postar, operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK ka paraqitur argumenta shtesë pranë KPP, protokolluar me tonën me nr.469/3 prot., datë 23.02.2026.

II.9 Me shkresën me nr. 4147/9 prot., datë 23.02.2026, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 469/4 prot., datë 24.02.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara ka dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Fedos” SHPK, vendim K.SHA nr. 27/2026, si dhe dokumentacionin e operatorit ekonomik të shpallur fitues paraprak për procedurën objekt ankimi. Referuar vendimit të KSHA rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

II.10. Vendimin e KSHA nr. 27/2026, autoriteti kontrktor e ka përcjellë pranë KPP edhe nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike në datën 24.02.2026, protokolluar me tonën me nr.469/5 prot., datë 24.02.2026.

II.11. Me publikimin e formularit të publikimit nr.469/8 prot., datë 26.02.2026 (korigjuar me vendimin nr. 316/2026, datë 25.02.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik), operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK, në cilësinë e subjektit të interesuar, në datën 04.03.2026, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, ka paraqitur argumenta shtesë, argumnta të cilat janë protokolluar me tonën me nr.469/9 prot., datë 04.03.2026.

II.12. Me shkresën me datë 04.03.2026 me lëndë *“Informacion plotësues dhe argumenta shtesë mbi ankesën ekzistuese të paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos SHPK ...”,* operatori ekonomik “Fedos” SHPK nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike ka dorëzuar argumente shtesë lidhur me vendimin e KSHA-së me nr. 27/2026, protokolluar me tonën me nr. 409/10 prot., datë 04.03.2026.

II.13. Shkresën e datës 04.03.2026 me lëndë *“Informacion plotësues dhe argumenta shtesë mbi ankesën ekzistuese të paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos SHPK ...”,* operatori ekonomik “Fedos” SHPK e ka përcjellë pranë KPP edhe nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar me tonën me nr.469/11 prot., datë 05.03.2026.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Fedos” SHPK për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Albadent Group” SHPK me arsyetimin si vijon: *“[...]Bazuar në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore të regjistruara në Republikën e Shqipërisë (përditësuar Dhjetor 2025), publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), <https://akbpm.gov.al/publikime/>, në përputhje me ligjin nr. 89, datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore”, operatori ekonomik Albadent Group në pesë vitet e fundit rezulton që të ketë regjistruar si pajisje mjekësore në Shqipëri vetëm produkte konsumi të cilat i përkasin fushës dentare dhe në asnjë rast pajisje mjekësore për përdorim spitalor të një shërbimi unik dhe me rëndësi kombëtare, siç janë edhe artikujt objekt prokurimi. Kujtojmë që artikujt e kësaj procedure janë produkte mjekësore shumë specifike dhe të rëndësishme të veçantë jetike, të cilat përdoren vetëm në shërbimin kombëtar të transfuziologjisë. Këto produkte janë shumë të veçanta për natyrën e përdorimit, filtrimin e mikroelementeve të gjakut dhe duhet të konsiderohen e vlerësohen me përgjegjësi të lartë për produktin përfundimtar që nxjerrin. Fakti që OE Albadent Group nuk ka regjistruar në Shqipëri asnjë produkt të tillë apo të ngjashëm në pesë vitet e fundit (sipas ligjit nr. 89, datë*

17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore”) na jep të drejtën për të shfaqur dyshimet tona të arsyeshme që ky operator nuk e plotëson pikën 2.3.1 të DST..”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën nr. 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pika 2.3.1 “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet si më poshtë:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit 2/shumatores së loteve që konkuron. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.2. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

LOTI 2: FILTRA DELEUKOCITAR DHE BASHKUES LABORATORI PËR MASAT TROMBOCITARE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë

ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës. Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike janë hartuar nga autoriteti kontraktor përfitues Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut për secilin lot, si më poshtë:

Duke u mbështetur në rekomandimet e Këshillit të Europës për cilësinë e gjakut dhe komponentëve të tij, si edhe në Praktikën e Mira Transfuzionale (GMP), filtrat deleukocitarë dhe setet bashkuese për trombocitet duhet të plotësojnë specifikimet teknike të mëposhtëme.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion teknik që vërteton përputhshmërinë me çdo kriter të mëposhtëm
- Për produktet me shenimin (*) duhet të sillen mostra për inspektim dhe vlerësim paraprak.

2.1 Filtra deleukocitarë për një njësi(*)

1. Filtri duhet të jetë **i tipit bedside**, i përshtatshëm për filtrimin e masave eritrocitare gjatë administrimit të tyre tek pacienti.
2. Performanca e filtrit duhet të jetë e tillë që, të sigurojë reduktim të leukociteve **nën 5×10^5 leukocite residuale/njësi**.
3. Rikuperimi i eritrociteve pas filtrimit duhet të jetë **jo më pak se 90%**.
4. Sistemi duhet të jetë i mbyllur, steril, njëpërdorimësh.
5. Filtri duhet të jetë i përputhshëm me të gjitha llojet standarde të qeseve të gjakut për masë eritrocitare dhe me të gjithë antikoagulantët dhe solucionet aditive në përdorim.
6. Filtri duhet të jetë i pajisur me kamerë pikimi transparente dhe vetëniveluese, për mbushje të shpejtë dhe automatike të kamerës pikuese pa nevojë për shplareje me solucion fiziologjik përpara filtrimit.
7. Filtri duhet të ketë rregullues fluksi të tipit "roller clamp" për kontroll të saktë të rrjedhës.
8. Filtri duhet të jetë i pajisur me valvul ajrimi vetëshkarkuese me filtër bakterial, që mundëson drenim të plotë të gjakut pas filtrimit, duke ruajtur sterilitetin e sistemit dhe siguruar rikuperim të lartë të eritrociteve.

9. Filtri duhet të jetë i lehtë në përdorim dhe të lejojë filtrim përmes forcës së gravitetit, pa nevojë për pajisje shtesë.
10. Filtri duhet të jetë i pakeluar individualisht, steril dhe latex free. Gjatë procesit të prodhimit nuk duhet të jenë përdorur ngjitës kimikë.
11. Etiketa dhe paketimi duhet të përmbajnë numrin e lotit, datën e prodhimit, datën e skadencës, kushtet e ruajtjes.
12. Filtri duhet të ketë markim CE në përputhje me Rregulloren (BE) 2017/745 (MDR) për pajisjet mjekësore ose FDA.
13. Çdo lot i furnizuar duhet të shoqërohet me Certifikatë Analize (CoA).
14. Skadenca e produktit duhet të jetë jo më pak se **12 muaj** nga data e dorëzimit.
15. Ofertuesi duhet të paraqesë **mostër të filtrit** për inspektim visual dhe vlerësim paraprak.

2.2 Filtra Deleukocitarë Laboratori për njësi (*)

1. Filtri duhet të jetë i **tipit laboratorik**, i projektuar për filtrimin e njësive të masave eritrocitare në repartin e përpunimit.
2. Filtri duhet të jetë i përshtatshëm për filtrimin e një njësie të vetme mase eritrocitare.
3. Performanca e filtrit duhet të jetë e tillë që, numri rrezidual i leukociteve në masën eritrocitare të jetë $< 5 \times 10^4$ /njësi.
4. Rikuperimi i eritrociteve pas filtrimit duhet të jetë **jo më pak se 90%**.
5. Filtri duhet të mundësojë mbushje automatike të sistemit, pa nevojë për shpëlarje me solucion fiziologjik në fillim të procesit për të garantuar lehtësi maksimale në përdorim dhe për të shmangur futjen e ajrit në sistem.
6. Filtri duhet të përfshijë mekanizëm të integruar për eliminimin e ajrit.
7. Filtri duhet të ketë qese transferimi të dedikuar për eritrocitet e filtruara, me portë mbylljeje hermetike dhe sipërfaqe për etiketim.
8. Filtri duhet të jetë i lehtë në përdorim dhe të lejojë filtrim përmes forcës së gravitetit, pa nevojë për pajisje shtesë.
9. Filtri duhet të jetë i përputhshëm me të gjitha llojet standarde të qeseve të gjakut për masa eritrocitare dhe me të gjithë antikoagulantët dhe solucionet aditive në përdorim.
10. Filtri duhet të funksionojë në temperaturë 2–30°C, pa humbje performace.
11. Filtri duhet të jetë i pajtueshëm me pajisjet ekzistuese të ngjitjes sterile në QKTGJ.
12. Materialet plastike duhet të jenë apirogjene, jo toksike dhe rezistente ndaj kompresimit mekanik gjatë procesit të filtrimit. Gjatë procesit të prodhimit nuk duhet të jenë përdorur ngjitës kimikë.
13. Etiketa dhe paketimi duhet të përmbajnë numrin e lotit, datën e prodhimit, datën e skadencës, kushtet e ruajtjes.
14. Produkti duhet të jetë i pakeluar individualisht, hermetikisht, dhe latex free.
15. Filtri duhet të ketë markim CE në përputhje me Rregulloren (BE) 2017/745 (MDR) për pajisjet mjekësore ose FDA.
16. Çdo lot i furnizuar duhet të shoqërohet me Certifikatë Analize (CoA).
17. Skadenca e produktit duhet të jetë jo më pak se **12 muaj** nga data e dorëzimit.
18. Ofertuesi duhet të paraqesë **mostër të filtrit** për inspektim visual dhe vlerësim paraprak.

2.3 Set Deleukocitar dhe Bashkues Laboratori për Masat Trombocitare(*)

1. *Setet deleukocitare dhe bashkuesit e laboratorit për masat trombocitare duhet të jenë të projektuar për lidhje sterile të të paktën 6 masave trombocitare.*
2. *Tubat plastike duhet të jenë material plastik PVC mjekësor, apirogjen, jotoksik.*
3. *Tubat plastike duhet të jenë të pajisur me kapse plastike (clamp) për bllokim/mbyllje të sigurt.*
4. *Seti duhet të jetë i projektuar për funksionim në sistem të mbyllur, pa rrezik kontaminimi.*
5. *Seti duhet të jetë i pajtueshëm me pajisjet ekzistuese të ngjitjes sterile në QKTGJ*
6. *Seti të jetë i përshtatshëm për bashkimin e trombociteve të prodhuar me sistemin Reveos (ose ekuivalent), me filtër in-line të përshtatshëm për filtrimin e pool-it të trombociteve me gravitet.*
7. *Performanca e filtrit duhet të jetë e tillë që, numri rrezidual i leukociteve në pool-in e trombociteve të jetë nën $<0.1 \times 10^6$ leukocyte residual/për njësi.*
8. *Rekuperimi i trombociteve pas filtrimit duhet të jetë jo më pak se 90%.*
9. *Koha e filtrimit jo më gjatë se 8-10min.*
10. *Seti duhet të përmbajë një qese të vogël (in-line) për marrjen e mostrave për kontrollin e cilësisë nga qesja kryesore.*
11. *Qesja kryesore duhet të sigurojë permeabilitet të mjaftueshëm të membranës për ruajtjen e trombociteve.*
12. *Seti duhet të jetë tërësisht steril dhe njëpërdorimësh.*
13. *Paketimi duhet të jetë individual, i mbyllur hermetikisht (single sterile pack), rezistent ndaj lagështirës dhe faktorëve të ambientit.*
14. *Etiketa dhe paketimi duhet të përmbajnë numrin e lotit, datën e prodhimit, datën e skadencës, kushtet e ruajtjes.*
15. *Filtri duhet të ketë markim CE në përputhje me Rregulloren (BE) 2017/745 (MDR) për pajisjet mjekësore ose FDA.*
16. *Çdo lot i furnizuar duhet të shoqërohet me Certifikatë Analize (CoA).*
17. *Skadencia e produktit duhet të jetë jo më pak se 12 muaj nga data e dorëzimit.*
18. *Ofertuesi duhet të paraqesë mostër të setit për inspektim visual dhe vlerësim paraprak.*

III.1.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Albadent Group” ShPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

Faturë tatimore nr. 1669, datë 28.01.25;
 Faturë tatimore nr. 23925, datë 01.12.25;
 Faturë tatimore nr. 6841, datë 15.04.25;
 Faturë tatimore nr. 23441, datë 24.11.25,
 Faturë tatimore nr. 41214, datë 13.12.24;
 Faturë tatimore nr. 38295, datë 04.12.24;
 Faturë tatimore nr. 26537, datë 09.06.23;
 Faturë tatimore nr. 28902, datë 20.07.23;
 Faturë tatimore nr. 38295, datë 04.12.24;
 Faturë tatimore nr. 670, datë 14.01.25;
 Faturë tatimore nr. 22377, datë 29.03.23;
 Faturë tatimore nr. 38100, datë 06.12.23;

Faturë tatimore nr. 18803, datë 31.01.23;
Faturë tatimore nr. 27110, datë 31.05.24;
Faturë tatimore nr. 26876, datë 15.06.23;
Faturë tatimore nr. 33074, datë 22.09.23;
Faturë tatimore nr. 26036, datë 31.05.23;
Faturë tatimore nr. 21276, datë 10.03.23;
Faturë tatimore nr. 1919, datë 30.01.25;
Faturë tatimore nr. 5914, datë 28.03.25;
Faturë tatimore nr. 1527/2023, datë 30.09.2023;
Faturë tatimore nr. 371815471/2023, datë 08.02.2023;
Faturë tatimore nr. 371818374/2023, datë 01.07.2023;
Faturë tatimore nr. 1033/2024, datë 20.02.2024;
Faturë tatimore nr. 7915/2024, datë 04.12.2024;
Faturë tatimore nr. 371815777/2023, datë 21.02.2023;
Faturë tatimore nr. 1424/2023, datë 26.09.2023;
Faturë tatimore nr. 2921/2023, datë 30.11.2023;
Faturë tatimore nr. 2301/2023, datë 01.11.2023;
Faturë tatimore nr. 2589/2023, datë 14.11.2023;
Faturë tatimore nr. 371816621/2023, datë 05.04.2023;
Faturë tatimore nr. 6698/2024, datë 24.09.2024;
Faturë tatimore nr. 220/2023, datë 02.08.2023;
Faturë tatimore nr. 294/2024, datë 15.01.2024;
Faturë tatimore nr. 7369/2024, datë 16.10.2024;
Faturë tatimore nr. 9291/2024, datë 19.12.2024;
Faturë tatimore nr. 17312, datë 08.01.24;
Faturë tatimore nr. 587, datë 13.01.25;
Faturë tatimore nr. 33671, datë 02.09.24;
Faturë tatimore nr. 40474, datë 04.12.24;
Faturë tatimore nr. 25912, datë 01.06.23;
Faturë tatimore nr. 33021, datë 21.09.23;
Faturë tatimore nr. 33086, datë 22.09.23;
Faturë tatimore nr. 31310, datë 24.08.23;
Faturë tatimore nr. 33096, datë 22.09.23;
Faturë tatimore nr. 20756, datë 01.03.23;
Faturë tatimore nr. 23126, datë 30.03.24;
Faturë tatimore nr. 42279, datë 30.12.24.

III.1.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar 32 kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.5. Neni 40, pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, e VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasisht e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisht e mallrave të furnizuara.”.

III.1.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në

dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK, në përmbushje të kriterit për furnizime të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit, nga krahasimi i specifikimeve teknike të mallrave objekt i këtyre faturave tatimore, të realizuara dhe të dorëzuara nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK, me specifikimet teknike të produkteve objekt-prokurimi të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të specifikimeve dhe funksionit të mallrave objekt i faturave tatimore, dëshmime të furnizimeve të ngjashme të dorëzuar nga ana e këtij operatorit ekonomik parë kjo në rrafshin krahasimor me specifikimet teknike dhe funksionalitetin e produkteve objekt-prokurimi të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Kështu, referuar Shtojcës 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike” pjesë e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në listën e mallrave objekt-prokurimi, produktet si më poshtë: Filtra deleukocitar për një njësi ; Filtra deleukocitar laborator për një njësi ; Filtra deleukocitar laborator për një njësi. Në rastin konkret, KPP gjykon, se nuk kemi të bëjmë me materiale mjekimi të zakonshme, por me produkte mjekësore specifike që përdoren për të përgatitur dhe përmirësuar cilësinë e komponentëve të gjakut për transfuzion mjekësor. Këto produkte janë të lidhura drejtpërdrejt me shërbimin e transfuziologjisë dhe përdoren për të garantuar sigurinë dhe efektivitetin e procesit të transfuzionit të gjakut, duke siguruar përpunimin dhe filtrimin e komponentëve të gjakut përpara përdorimit tek pacientët. Në këtë mënyrë, KPP vlerëson se kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit lidhet me furnizimin me produkte të cilat përdoren për shërbime shëndetësore specifike, sikurse është transfuzioni i gjakut, një shërbim me rëndësi të veçantë për sistemin shëndetësor.

Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të

zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohej, kjo për të analizuar në thelb *ratio legis*, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmimeve për furnizimet e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të furnizimeve të mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e dëshmimeve për furnizime të mëparshme ligjvënësi në nenin 40 pika 4 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter në rastin e furnizimeve të ngjashme të realizuara me ente publike mund të përmbushet me paraqitjen e dëshmimeve të lëshuara nga ente publike për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme dhe në një vlerë jo më të madhe se 40 % të vlerës së fondit limit të procedurës së prokurimit në të cilën merr pjesë ofertuesi, ndërsa në rastin e furnizimeve të ngjashme të realizuara me subjekte private mund të përmbushet me paraqitjen e një ose disa faturave tatimore të shitjes të plotësuar sipas legjislacionit në fuqi ku shënohen data, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ku vlera e tyre të jetë jo më e madhe se 40 % të vlerës së fondit limit të procedurës së prokurimit në të cilën merr pjesë ofertuesi. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës trevjeçare sikundër parashikohet edhe në Vendim të Këshillit të Ministrave.

III.1.8. Sa më sipër, në analizë të thelluar dhe krahasimore të faturave tatimore të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik “Albadent Group” SHPK, KPP konstaton se ofertuesi “Albadent Group” SHPK për plotësimin e kriterit kualifikues lidhur me furnizimet e ngjashme ka dorëzuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi fatura tatimore të shitjes të realizuara me subjekte private, të listuara në pikën III.1.3 të këtij vendimi, fatura të cilat përmbushin komponentin “afat kohor”, sepse janë lëshuar brenda afatit 3 vjeçar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës. Nëpërmjet faturave të paraqitura, operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK dëshmon se ka kryer furnizimin me materiale, të cilat në asnjë rast nuk dëshmojnë se disponon eksperiencën e nevojshme dhe që ka kryer furnizime të ngjashme me produkte për transfuzionin e gjakut, ashtu sikurse janë të destinuara të perdoren mallrat objekt prokurimi, të cilat referuar specifikimeve teknike ndryshe nga materialet e paraqitura nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK, në fokusin e tyre kanë si komponent kryesor produkte për transfuzionin e gjakut, ndërsa furnizimet e kryera nga operatori ekonomik janë furnizime të materialeve ortodontike për përdorim stomatologjik. Referuar mallrave objekt prokurimi evidentohen produkte specifike mjekësore për përgatitjen e gjakut për transfuzion si, Filtrat deleukocitar për një njësi, Filtrat deleukocitar laborator për një njësi: Set deleukocitar + bashkues laborator për masat trombocitare.

Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë furnizimi mallra, por si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, por edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë

të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën duke iu referuar qëllimit (*ratio legis*) të kërkesës për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në rastin konkret, kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues janë furnizim me materiale dhe pajisje ortodontike, ndërsa mallrat objekt i procedurës së prokurimit janë të destinuara për një përdorim më specifik shëndetësor, sikurse është transfuzioni i gjakut. Këto produkte përdoren në trajtimin e problemeve të gjakut dhe nuk mund të konsiderohen të ngjashme me materialet ortodontike të cilat janë të destinuara ekskluzivisht për trajtime dentare dhe ortodontike. Produktet dentare janë të një natyre ambulatorie dhe kanë një përdorim të lokalizuar, lokalisht invazive, përdorim specifik dentar, ndërsa produktet mjekësore objekt prokurime (Filtrat deleukocitar për një njësi, Filtrat deleukocitar laborator për një njësi: Set deleukocitar + bashkues laborator për masat trombocitare) përdoren për shërbime mjekësore specifike dhe më komplekse. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi kontratat e paraqitura përmbajnë objekt dhe zëra të cilat nuk janë të ngjashëm me objektin e prokurimit. Sa më sipër, KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Referuar kriterit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga ky operator ekonomik, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Kriteret për kualifikim, vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kontratat e mësipërme të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.1, të kapacitetit teknik.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik “Albadent Group” SHPK nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit, operatori ekonomik është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, të paraqesë çdo dokumentacion që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi nuk ka ofertuar sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e tenderit. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me

kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: *“Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”*; *“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me parimin: a) Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale”*, KPP gjykon se operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK duhet të kishte dorëzuar kontrata të ngjashme sipas kërkesave dhe specifikave të autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.10. Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementesh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë 38 nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”*. Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Albadent Group” SHPK me arsyetimin si vijon:

“Kërkojmë një ekspertizë të posacme për testim dhe vlerësim paraprak të mostrave të dërguara nga operatori ekonomik në momentin e hapjes së tenderit që vërteton përputhshmërinë me çdo kriter të kërkuar në specifikimet teknike”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe KPP, për këto pretendime, operatori ekonomik ankimues, nuk parashtrohet fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime a-priori, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me mosplotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

III.2.1. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3: - Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

III.2.2. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij për mospërmblidhjen nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK të kriterit të përcaktuar në pikën 6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, ankimuesi “Fedos” SHPK duhet të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ky pretendim. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.2.3. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë, se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmblidhjen e kriterit/kriterëve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmblidhja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin, etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmblidhje kriteri/kriteresh.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë, në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.2.5. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficientë e procedurave të prokurimit publik, përmes

nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim proaktiv, në krah të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plota provuese, se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrojnë pretendime a-priori duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij. Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”. Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.2.6. Një pretendim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar para tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik është parë nga ligji si një quasi gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e saj, KPP zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një pretendim, i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme. Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK, për mospërmblidhjen nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK të kriterit të përcaktuar në pikën 6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, nuk merret në shqyrtim.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Fedos” SHPK për kundërshtimin e kualifikimi të operatorit ekonomik “Albadent Group” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi në procesin e shqyrtimit administrativ, pasi referuar gjykimit më sipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Albadent Group” SHPK do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për*

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72023-12-12-2025, me objekt: “LOTI 2 Filtra deleukocitar dhe bashkues laborator për masat trombocitare”, me fond limit 18,960,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit “Albadent Group” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK SHPK .
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

